

VENDIM
Nr. 447, datë 26.7.2018

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 319, DATË 15.4.2015, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË
NDËRSEKTORIALE PËR REFORMËN NË ADMINISTRATËN PUBLIKE
2015–2020”**

Në mbështetje të pikës 1, të nenit 100, të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 319, datë 15.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2, emërtimi “ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike” zëvendësohet me “Zëvendëskryeministri”.

2. Në dokumentin bashkëlidhur vendimit bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

a) Pas ndarjes “Financimi i strategjisë” shtohet ndarja “Vlerësimi i ri i kostos për planin e ri të aktiviteteve të strategjisë për periudhën 2018–2020”, me përmbajtje sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Pas lidhjes nr. 1 shtohet lidhja nr. 1/1, “Plani i aktiviteteve dhe treguesit për periudhën 2018–2020”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Pas lidhjes nr. 2 shtohet lidhja nr. 2/1, “Vlerësimi i detajuar i kostos për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike për planin e veprimit për periudhën 2018–2020”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ç) Kudo në dokument:

- emërtimi “Agjencia Shqiptare për Ofrimin e Integruar të Shërbimeve” zëvendësohet me “Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara”;

- shkurtesa “DPZHNH” zëvendësohet me “DZHM” dhe emërtimi “Departamenti i Programimit, Zhvillimit dhe Ndihmës së Huaj” zëvendësohet me “Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes”;

- shkurtesa “MF” zëvendësohet me “MFE” dhe emërtimi “Ministria e Financave” zëvendësohet me “Ministria e Financave dhe Ekonomisë”;

- shkurtesa “MIAP”, emërtimi “Ministër/ri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike” dhe fjalët “ministri përgjegjës për administratën publike dhe inovacionin” zëvendësohen me emërtimin “Zëvendës-kryeministri”;

- shkurtesa “MSHÇV” zëvendësohet me fjalët “ministri përgjegjës për çështjet vendore”;

- shkurtesat “QKL” dhe “QKR” zëvendësohen me shkurtesën “QKB” dhe emërtimet “Qendra Kombëtare e Licencimit” dhe “Qendra Kombëtare e Regjistrimit” zëvendësohen me emërtimin “Qendra Kombëtare e Biznesit”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VLERËSIMI I RI

I KOSTOS PËR PLANIN E RI TË AKTIVITETEVE TË STRATEGJISË, PËR PERIUDHËN 2018–2020


Përcaktimi i kostos së realizimit për planin e ri të aktiviteteve për periudhën 2018–2020 u realizua nëpërmjet procesit të vlerësimit të kostos potenciale të nevojshme nga secili institucion, i cili ka përgjegjësinë kryesore në realizimin e aktiviteteve të parashikuara, si dhe bazuar në vlerësimet aktuale të realizuara në kuadër të projekteve të ndryshme që po financojnë një sërë reformash në administratën publike. Duhet të theksohet këtu se kostimi i bërë në momentin e miratimit të SNRAP 2015–2020, për aktivitetet e periudhës 2018–2020, është përfshirë në kostimin e ri.

Fondet e vlerësuara të nevojshme për zbatimin e veprimeve të planit të ri të aktiviteteve të SNRAP-it për periudhën kohore 2018–2020, parashikohet të jenë në nivelin rreth 1.72 miliardë lekë ose rreth 13.23 milionë euro (për qëllime llogaritjeje është përdorur kursi i këmbimit EUR/ALL 1=130), të detajuara sipas lidhjes 2/1 “Vlerësimi i detajuar i kostos për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën e Administratës Publike për Planin e Veprimit për periudhën 2018–2020”. Duhet të përmendim këtu që në kostimin e strategjisë nuk është përfshirë kostoja administrative (pagesa e nëpunësve, të cilët kryejnë aktivitetet e tyre për shkak të detyrave të tyre funksionale), si dhe nuk janë kostuar 7 aktivitetet, të cilat lidhen me procedurat e thjeshtuara për ofrimin e shërbimeve dhe zhvillimin e infrastrukturës TIK, për arsye se kjo varet nga proceset që paraprijnë këto aktivitete.

Tabela 4. Kostoja e financimit sipas fushave për periudhën 2018–2020

Fushat	Vlera (000 lekë)
Politikëbërja dhe cilësia e legjislacionit	143,463
Organizimi dhe funksionimi i administratës publike	1,293,799
Shërbimi civil: menaxhimi i burimeve njerëzore	86,931
Procedurat administrative dhe mbikëqyrja	195,960
TOTALI	1,720,154

Grafiku nr. 4. Peshat specifike të kostos sipas fushave të SNRAP-it




Siç vihet re, nga tabela 4 më sipër, peshën specifike më të madhe e zënë shpenzimet për zbatimin e aktiviteteve në fushën e organizimit dhe funksionimit të administratës publike, të cilat janë investime në fushën kryesisht të inovacionit, ku peshën kryesore e zënë investimet për sistemin IPSIS dhe objektivat që lidhen me përmirësime të shërbimeve ndaj publikut me qëllim rritjen e eficiencës, transparencës dhe komunikimit me publikun, të cilat, në një masë të madhe, përfshijnë një reformë të thellë në drejtim të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit.

Shpenzimet për investimet në ICT zënë gati 72% të totalit të investimeve të nevojshme për zbatimin e reformës në administratën publike në vitet e ardhshme. Krahësuar me planin e kaluar 2015–2017, shpenzimet e trajnimit kanë pësuar një rritje në peshë specifike, nga rreth 4% në rreth 11% në planin e ri. Kjo rritje e peshës specifike vjen si rezultat i zbatimit të programit të shkëmbimit të eksperiencës së punonjësve të rinj të administratës publike, i cili financohet në masën 1 milion EUR.

Tabela 5. Zërat e shpenzimeve për periudhën 2018–2020

Zërat	Vlera (000 lekë)
Fond page	9,838
Shpenzime trajnimi	193,910
Ekspertizë	263,037
Investime ICT	1,234,997
Shpenzime të tjera dhe mirëmbajtjeje	18,370

Grafiku nr. 5. Peshat specifike e kostos sipas zërave të SNRAP-it




TOTALI **1,720,154**

Duhet përmendur që niveli i boshllëkut financiar është shumë i ulët. Ai përllogaritet të jetë vetëm 4% (grafiku 6 më poshtë). Ky nivel mund të ulët më tej nëse një pjesë e aktivitetëve të planifikuar do të mbështeten nga OECD/SIGMA në fusha ku asistencë e kësaj të fundit ka qenë e rëndësishme për qeverinë, si: RIA, konsultimi publik etj.

Tabela 6. Burimet e financimit

	Vlera (000 lekë)
Buxheti i shtetit	905,932
EU (IPA)	290,021
Donatorë të tjerë	37,028
Banka Botërore	87,364
UNDP	332,594
Boshllëku Financiar	67,213

Grafiku 6. Peshat e specifike sipas burimeve të financimit



Në terma të fluksit të fondeve, siç jepet në tabelën 7, pjesa më e madhe e fondeve do të shpenzohen gjatë vitit 2018, dhe kjo lidhet me ecurinë e përfundimit të sistemit IPSIS dhe sistemeve të shërbimeve *online* të financuara nga projekti STAR 2 dhe Trust Fund i Bankës Botërore për sistemin IPSIS. Disa aktivitete të parashikuara për t'u zbatuar në vitin 2018 rezultojnë me boshllëk financiar.

Tabela 7. Fluksi i financimit/ *cash flow* (000 lekë)

2018	2019	2020
906,087	573,791	240,276

Duke pasur një mungesë financimi dhe për kohën e mbetur të limituar për gjetjen e fondeve, këto fonde janë parashikuar në pjesën më të madhe të tyre në vitin 2019.”

[illegible]

[illegible]

[illegible]

Vlerësimi i detajuar i koston për zbatimin e Strategjisë Ndërsëktoriale për Reformën e Administratës Publike, për periudhën 2018 - 2020

								Burimet e financimit (sipas produkteve)					
Nr. Aktivitetit	Detajimi i aktivitetit	Nr. i nënaktivitetit	Detajimi i nënaktivitetit	Institucioni raportues/përgjegjës	Komente për llogaritjen e koston	Kostoja e vlerësuar e produktit (000 lekë)	Buxheti i Shtetit (PBA 2018-2020)	DE	Donatorë të tjerë	Banka Botërore	UNDP	Boshllëku financiar	
Objekti 1: Politika planifikuese dhe koordinuese të përmirësuar për të hartuar dokumenta strategjikë të qeverisë që i shndërrojnë prioritetet në veprime konkrete													
Aktiviteti 1.1	Përmirësimi i procesit dhe cilësisë së hartimit dhe monitorimit të dokumenteve strategjike	Nënaktiviteti 1.1.1	Hartimi i metodologjisë për përgatitjen e dokumenteve strategjike (strategji, programe, plane veprimi, dokumente politikash etj).	DZHM	{Shih komentin e përgjithshëm nën-aktiviteti 1.1.4 }								
		Nënaktiviteti 1.1.2	Hartimi i paketës ligjore për funksionalitetin e sistemit IPSIS	DZHM		3,904				3,904			
		Nënaktiviteti 1.1.3	Funksionim i plotë i Sistemit të Informacionit për Sistemin e Planifikimit të Integruar - IPSIS ("go live" për IPSIS në 2019)	DZHM		83,460				83,460			
		Nënaktiviteti 1.1.4	Përmirësimi i kapaciteteve të Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes & ministrive të linjës në drejtim të monitorimit të politikave/strategjive/planeve të veprimit/programave zhvillimore, në përputhje me metodologjitë e IPSIS & AFMS	DZHM	Koment i përgjithshëm për të nënaktivitetet e IPSIS (1.1.1 - 1.1.4) - Të gjitha koston për zhvillimin e nënaktiviteteve 1.1.1 - 1.1.4 janë të mbuluara nga IPS2 TF.							-	
Aktiviteti 1.2	Përmirësimi i instrumenteve për politikën për zhvillim dhe mirëqeverisje, në nivel qendror dhe në nivel sektori.	Nënaktiviteti 1.2.1	Përgatitja e një Udhërrëfyesi për Objektivat e Zhvillimit të Mirëqeverisjes (fazë paraprake si pjesë e procesit të përgatitjes së Strategjisë Kombëtare për 2020)	DZHM		1,950					1,950		
		Nënaktiviteti 1.2.2	Rishikimi i bazës ligjore dhe kuadrit rregullator për funksionimin e IPMG-ve dhe/ose SWG për të adresuar sfidat në strukturat e qeverisë dhe ndryshimin e funksioneve	DZHM		2,925						2,925	
		Nënaktiviteti 1.2.3	Përgatitja e formave standarde (tool kit) për funksionimin e IPMG për Mirëqeverisjen & udhëzime operacionale/Progresi IPMG (rishikimi i kuadrit rregullator për funksionimin e IPMG për Mirëqeverisjen)	DZHM		2,145						2,145	
		Nënaktiviteti 1.2.4	Funksionimi sistematik i Grupit Tematik për Politikëbërjen, si dhe ngritja e rrjetit për politikëbërjen me njësitë e politikave në ministrinë e linjës	DZHM	kosto administrative								-
Totali koston Objekti 1						94,384	-	-	-	87,364	1,950	5,070	
Objekti 2: Sistem transparent i hartimit të ligjeve, gjithëpërfshirës, i bazuar në politika dhe që siguron përafrimin me acquis													

Aktiviteti 2.1	Përmirësimi i mekanizmave dhe instrumenteve të lidhura me konsultimin publik	Nëaktiviteti 2.1.1	Përgatitja e Udhëzimeve Operacionale për ML46 për kryerjen e procesit të konsultimit publik dhe funksionimin e e-regjistrit të konsultimit publik	DZHM/AKSHI		2,925					2,925	
		Nëaktiviteti 2.1.2	Trajnim/Ngritje kapacitetesh për stafin përgjegjës në ministritë e linjës për përdorimin e e-platformës së konsultimit publik	DZHM		163					163	
		Nëaktiviteti 2.1.3	Përgatitja e manualit për konsultimin publik (për publikun dhe ekspertët) për të lehtësuar pjesëmarrjen në konsultimet publike përmes përdorimit të regjistrit të e-konsultimit	DZHM		2,535					2,535	
		Nëaktiviteti 2.1.4	Publikimi në sistem i raporteve të konsoliduara që paraqesin nivelin e reflektimit të komenteve të publikut	DZHM	kosto administrative							
		Nëaktiviteti 2.1.5	Monitorimi i rregullt i realizimit të procesit të konsultimit publik	DZHM		7,020					7,020	
Aktiviteti 2.2	Zbatimi i procedurës për kryerjen e vlerësimit të ndikimit rregulator (vlerësimi ex-ante) gjatë procesit të hartimit të politikave/legjislacionit, bazuar në të dhëna dhe dëshmi	Nëaktiviteti 2.2.1	Vendosja e rregullave që bëjnë të detyrueshëm zbatimin e procesit të Vlerësimit të Ndikimit Përditësimi i Metodologjisë së Vlerësimit të Ndikimit (RIA), në përputhje me nevojat dhe zhvillimet e mëtejshme të procesit	DPP	kosto administrative						-	
		Nëaktiviteti 2.2.2	Forcimi i kapaciteteve, nëpërmjet trajnimeve të ndryshme të nëpunësve (Rrjeti RIA) në ministritë e linjës dhe Kryeministri, me qëllim përmirësimin e procesit të vlerësimit të ndikimit	NJPARR	kosto administrative							-
		Nëaktiviteti 2.2.3	Forcimi i kapaciteteve, nëpërmjet trajnimeve të ndryshme të nëpunësve (Rrjeti RIA) në ministritë e linjës dhe Kryeministri, me qëllim përmirësimin e procesit të vlerësimit të ndikimit	NJPARR		1,726						1,726
		Nëaktiviteti 2.2.4	Aplikimi i Vlerësimit të Ndikimit (RIA) për aktet ligjore të rëndësishme që hartohen nga ministritë e linjës	NJPARR	kosto administrative							-
		Nëaktiviteti 2.2.5	Përcaktimi i kriterëve të kontrollit të cilësive së RIAs	NJPARR		1,170						1,170
Aktiviteti 2.3	Rritja e transparencës në botimin e legjislacionit	Nëaktiviteti 2.4.1	Monitorimi i vazhdueshëm i akteve të konsoliduara, botimi periodik në faqet e internetit të institucioneve	DRrP	kosto administrative						-	
Aktiviteti 2.4	Forcimi i masave për planifikimin e Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve (PPAP), me synim harmonizimin me PKIE dhe zvogëlimin e numrit të projektligjeve të paraqitura në Kuvend jashtë këtij programi	Nëaktiviteti 2.4.1	Përmirësimi i procesit të planifikimit të hartimit të akteve ligjore nëpërmjet përcaktimit të afatëve dhe rregullave të përgjithshme të procesit të hartimit të PPAP	ML	kosto administrative						-	
		Nëaktiviteti 2.4.2	Dërgimi sistematik në Parlament i planit analitik të akteve brenda muajt dhjetor të çdo viti	DRrP	kosto administrative							-
		Nëaktiviteti 2.4.3	Monitorimi sistematik i zbatimit të Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve	DRrP	kosto administrative							-
Totali koston Objektivi 2						15,539	-	-	-	-	15,539	
Objektivi 3: Ndërtimi i një sistemi monitorimi dhe vlerësimi efikas të strategjive, programeve dhe kuadrit ligjor në fuqi, të mbështetur në: 1) mbledhjen e të dhënave, nëpërmjet një procesi asnjëanshë dhe transparent, për hartimin dhe zbatimin e strategjive, programeve dhe legjislacionit, si dhe 2) në hartimin e analizave për vlerësimin e efekteve të krijuara nga zbatimi.												
Aktiviteti 3.1	Përmirësimi i mekanizmave për monitorimin e kuadrit strategjik dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2020	Nëaktiviteti 3.1.1	Monitorimi sistematik i zbatimit të Planit Vjetor të hartimit të Dokumenteve Strategjike	DZHM/ML	kosto administrative						-	
		Nëaktiviteti 3.1.2	Vendosja e një procesi sistematik për monitorimin e dokumenteve strategjike përmes moduleve IPSIS	DZHM/ML		7,150					7,150	
		Nëaktiviteti 3.1.3	Përgatitja e Manualit të Trajnimit për stafet e ministrive të linjës në lidhje me monitorimin e kuadrit strategjik (strategji/programe/dokumente politikash) dhe trajnimi i stafit	ML/DZHM		26,390					26,390	
Totali koston Objektivi 3						33,540	-	-	-	-	33,540	
Objektivi 4: Fuqizimi i strukturave të administratës publike me qëllim përmirësimin e ofrit të shërbimeve ndaj publikut.												

Aktiviteti 4.1	Rishikimi funksional dhe i organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore	Nënaktiviteti 4.1.1	Pilotimi i metodologjisë së SIGMA për ristrukturimin në 3 sisteme ministrore (institucionet e varësisë)	DAP		2,080		2,080				
		Nënaktiviteti 4.1.2	Vënia në zbatim e modelit të ri të organizimit për institucionet e varësisë në 3 sistemet e pilotuara	DAP	kosto administrative		-				-	
		Nënaktiviteti 4.1.3	Përkufizimi i tipologjisë standarde të organizimit të institucioneve të varësisë dhe miratimi i tyre	DAP		10,530		10,530				
Aktiviteti 4.2	Mëshkëtojtja për funksionimin e NJQV dhe forcim të kapaciteteve zbatuese	Nënaktiviteti 4.2.1	Publikimi i udhëzimeve për menaxhimin e burimeve njerëzore mbi politikën dhe praktikën në nivel lokal	AMVV	kosto administrative						-	
		Nënaktiviteti 4.2.2	Adoptimi i formateve standarde për përshkrimin e punës, procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të performancës bazuar në Toolkit për menaxhimin e burimeve njerëzore	AMVV	kosto administrative						-	
		Nënaktiviteti 4.2.3	Zbatimi i procesit të arkivimit fizik të dokumentacionit në secilin bashki	NJQV		64,764					64,764	
		Nënaktiviteti 4.2.4	Rritja e kapaciteteve institucionale për përfshirjen dhe konsultimin e publikut	NJQV/ASPA		7,471		7,471				
Totali koston Objektivi 4						84,845	-	10,530	9,551	-	64,764	-
Objekti 5. Shërbime publike të përmirësuara, të aksesueshme dhe të integruara duke reduktuar mundësitë për korrupsion dhe forcimin etikës në ofrimin e shërbimeve publike.												
Aktiviteti 5.1	Ngritja e Qendrave të Integruara për Ofrimin e shërbimeve publike	Nënaktiviteti 5.1.1	Ngritja dhe funksionimi i shtatë paku 9 Qendrave të Integruara për Ofrimin e shërbimeve publike në Tiranë dhe në rrethet	ADISA		502,273	502,273					
		Nënaktiviteti 5.1.2	Ngritja dhe funksionimi i shtatë paku 4 Njësive tërëzore për ofrimin e shërbimeve publike në zonat rurale	ADISA		29,841	29,841					
Aktiviteti 5.2	Ndarja e Administrimit të Sporteveve të Shërbimit (front office) për publikun nga zyrat përgjegjëse (back office) të shërbimit në institucionet qendrore.	Nënaktiviteti 5.2.1	Ndarja e sporteveve për 10 institucione qendrore	ADISA		177,273	177,273					
		Nënaktiviteti 5.2.2	Shtimi i të paktë 60 sporteveve me standarde të përmirësuara për ofrimin e shërbimeve publike në të gjitha qendrat e integruara ADISA	ADISA		177,273	177,273					
		Nënaktiviteti 5.2.3	Përshtatja e procedurave të reja të brendshme dhe manualeve të institucioneve sipas standardeve të reja të punës	ADISA		57,909		57,909				

Objektivi 7: Organizimi i sistemit të pagave në shërbimin civil duke u bazuar në vlerësimin e vendit të punës, të arritjeve vjetore të nëpunësve civilë dhe rezultateve në trajnimet e detyrueshme

Aktiviteti 7.1	Rishikimi dhe miratimi i strukturës së re të pagave	Nënaktiviteti 7.1.1	Hartimi dhe miratimi i një dokumenti për politikën e sistemit të pagave dhe miratimi i strukturës së re të pagave	DAP		19,890		19,890				
		Nënaktiviteti 7.1.2	Miratimi i vendimeve të reja për pagat dhe zbatimin e strukturës së re	DAP	kosto administrative							*
		Nënaktiviteti 7.1.3	Rishikimi i raporteve mes pagës maksimale dhe pagës minimale/mesatare në administratën publike, me qëllim rritjen e një piramide objektive të pagave dhe motivimin e pozicioneve drejtuese, si edhe diversifikimi i klasifikimit sipas përmbajtjes së punës	DAP	Dokumenti që do të hartohet në aktivitetin 7.1.1 do të përfshijë edhe një analizë të kësaj raporteve ndaj përfshihet tek kosto e kësaj aktiviteti						*	
Totali koston Objektivi 7						19,890	-	19,890	-	-	-	-
Objekti 8: Procedura të thjeshtuara për ofrimin e shërbimeve, duke lehtësuar komunikimin me publikun dhe shmangur korrupsionin												
Aktiviteti 8.1	Ri-inxhinierimi i shërbimeve publike, si një masë e nevojshme për thjeshtimin e procedurave administrative dhe uljen e numrit të hapave që duhet të ndërmarrin qytetarët dhe personeli mbështetës	Nënaktiviteti 8.1.1	Lehtësimi i procedurave të marrjes së shërbimeve në sportel, nëpërmjet miratimit të akteve ligjore për reduktimin/eliminimin e dokumenteve dhe/ose procedurave të punës	ADISA	kosto administrative							*
		Nënaktiviteti 8.1.2	Standardizimi nga ADISA i formularëve të aplikimit për shërbimet publike	ADISA	kosto administrative							*
		Nënaktiviteti 8.1.3	Shtimi i numrit të shërbimeve për të cilat informacioni ofrohet nëpërmjet 3 sistemeve alternative (internetit, mobile app, call center) të ngritur nga ADISA	ADISA	kosto administrative							*
Aktiviteti 8.2	Deregullimi, si masë për reduktimin drastik të dokumenteve të kërkuara nga qytetarët/bizneset dhe kalimin në një nivel të ri të modernizimit dhe dixhitalizimit të tyre	Nënaktiviteti 8.2.1	Lehtësimi i procedurave të marrjes së shërbimeve nga biznesi dhe qytetarët, në institucionet e administratës publike, nëpërmjet shtimit të shërbimeve me vlerë dixhitale	AKSHI	kostoja e kësaj aktiviteti do të përcaktohet pas përfundimit të procesit të deregulimit							-
		Nënaktiviteti 8.2.2	Modernizimi i shërbimeve publike nëpërmjet ofrimit të tyre elektronikisht në portalin qeveritar e-albania	AKSHI	kostoja e kësaj aktiviteti do të përcaktohet pas përfundimit të procesit të deregulimit							-
Aktiviteti 8.3	Krijimi i një mekanizmi që u mundëson qytetarëve të japin mendimin mbi cilësinë e shërbimeve elektronike në portalin e-albania	Nënaktiviteti 8.3.1	Zbatimi i funksionalitetit të vlerësimit me vje të cilësisë së shërbimit për të gjitha shërbimet elektronike të portalit e-albania	AKSHI	pjesë e kostove të mirëmbajtjes së shërbimeve të ndryshme në portal							-
Aktiviteti 8.4	Krijimi i kushteve dhe procedurave për zbatimin me transparencë dhe objektivitet të promovimit në karrierë në shërbimin civil	Nënaktiviteti 8.4.1	Identifikimi në mënyrë periodike i nevojave për trajnim nëpërmjet organizimit të procesit të Analizës së nevojave për trajnim (ANT)	ASPA	kosto administrative							*
		Nënaktiviteti 8.4.2	Ofrimi i një numri më të madh të trajnimeve në fushën e integritetit evropian në përputhje me hapjen e procesit të negociatave	ASPA		13,875	6,205	7,670				
		Nënaktiviteti 8.4.3	Përditësimi dhe zhvillimi i kapaciteteve trajnuese të ekspertëve (trajnerëve)	ASPA		1,359	1,359					
		Nënaktiviteti 8.4.4	Zbatimi i metodologjisë së hartuar nga ASPA për zhvillimin e vazhdueshëm profesional në institucionet e administratës shtetërore	ASPA	Kosto administrative							-
		Nënaktiviteti 8.4.5	Zhvillimi i planeve vjetore për trajnimin e drejtuesve të nivelit të mesëm dhe të lartë – bazuar në ofertën e trajnimit për TND	ASPA		1,379	1,379					
		Nënaktiviteti 8.4.6	Vlerësimi i qasjeve alternative në lidhje me trajnimin e drejtuesve, duke përfshirë edhe qasjen e bazuar tek kompetenca dhe pilotimi i saj në institucione të caktuara	ASPA	Kosto administrative							-
		Nënaktiviteti 8.4.7	Rritja e numrit të moduleve të trajnimeve të realizuara nëpërmjet platformës E-learning	ASPA		492	492					
Totali koston Objektivi 8						17,105	9,435	7,670	-	-	-	-
Objekti 9: Zhvillimi i një infrastrukture TIK të aftë për të mbështetur veprimtaritë e përditshme të administratës publike dhe rritjen e efikasitetit duke ulur kohën për të aksesuar, përpunuar dhe transmetuar informacionin ndërsa përmirësohet rrjedha e informacionit												
Aktiviteti 9.1	Diversifikimi i kanaleve të ofrimit të shërbimeve elektronike të portalit qeveritar e-albania	Nënaktiviteti 9.1.	Shtimi i entiteteve që ofrojnë shërbimet elektronike të portalit e-albania	AKSHI	kosto e kësaj aktiviteti do të përcaktohet pas vendosjes së numrit të entiteteve që do të ofrojnë shërbimet elektronike të portalit e-albania të shërbimeve të reja elektronike në Modulën "ONE STOP SHOP për nëpunësit qeveritarë"							*

Aktiviteti 9.2	Dixhitalizimi i regjistrave themeltarë, interoperabiliteti dhe rregjira e sistemeve të reja IT	Nënaktiviteti 9.2.1	Vijimi i procesit të dixhitalizimit të regjistrave themeltarë të institucioneve të qeverisjes qendrore	AKSHI	kostoja e këtij aktiviteti do të përcaktohet pas përfundimit të identifikimit dhe vendosjes së prioriteteve për regjistrat e qeverisjes qendrore që do të dixhitalizohen							-
		Nënaktiviteti 9.2.2	Shtimi i sistemeve të institucioneve të lidhura në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit, për të: (i) mundësuar komunikimin në kohë reale me njëra-tjetrën, (ii) lehtësuar aplikimet online, si dhe (iii) reduktuar dokumentet shqyruese në sportelet	AKSHI	kostoja e këtij aktiviteti do të përcaktohet pas përfundimit të identifikimit dhe vendosjes së prioriteteve për numrin e sistemeve që do të shtohen							-
		Nënaktiviteti 9.2.3	Zhvillimi i sistemeve të reja të institucioneve që nuk kanë sistem të brendshëm përpunimi të aplikimeve dhe dosjeve me të dhënat e qytetarëve (sistemet backend). Zhvillimi i sistemeve të përpunimit të aplikimeve dhe dosjeve me të dhënat e qytetarëve (sistemet backend), për institucionet ku këto sisteme mungojnë.	AKSHI	kostoja dhe afatet e këtij aktiviteti do të përcaktohen pas përfundimit të identifikimit dhe vendosjes së prioriteteve për regjistrat që do të dixhitalizohen							-
Aktiviteti 9.3	Zhvillimi dhe përdorimi i një sistemi të integruar TIK për sportelet e ofrimit të shërbimeve të institucioneve qendrore për qytetarët	Nënaktiviteti 9.3.1	Përfshirja e shërbimeve të reja elektronike në Modulin "ONE STOP SHOP" për nëpunësit qeveritarë"	AKSHI	kostoja e këtij aktiviteti do të përcaktohet pas përfundimit të shërbimeve të reja elektronike në Modulin "ONE STOP SHOP" për nëpunësit qeveritarë"							-
Totali koston Objekti 9												
Objekti 10: Rritja e efikasitetit dhe përgjegjëshmërisë së nëpunësve publikë.												
Aktiviteti 10.1	Aplikimi i metodave të reja për rritjen e efikasitetit, përgjegjëshmërisë, angazhimit dhe motivimit të punonjësve publikë	Nënaktiviteti 10.1.1	Trajnimi i administratës publike për zbatimin e kodit të procedurave administrative sipas kurrikulës së ASPA	ASPA		13,000		13,000				
		Nënaktiviteti 10.1.2	Aplikimi i instrumenteve të rinjë për të përmirësuar kulturën organizative në institucionet shtetërore	DAP		25,740		25,740				
		Nënaktiviteti 10.1.3	Zbatimi i programit "Young Civil Servant Scholarship Scheme" dhe qëndrueshmëria e kësaj praktike	DAP		130,000		130,000				
Totali koston Objekti 10						168,740	-	168,740	-	-	-	-
Objekti 11: Rritja e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike, garantimi i të drejtave të qytetarëve dhe aksesit në informacion												
Aktiviteti 11.1	Vënia në eksitim e programit institucional të transparencës nga autoritetet publike	Nënaktiviteti 11.1.1	Plotësimi me programet e transparencës për të gjitha institucionet e administratës qendrore	KDIMDH	Kosto administrative							-
		Nënaktiviteti 11.1.2	Hartim i programeve model të transparencës për pushtetin vendor	KDIMDH		3,736						3,736
		Nënaktiviteti 11.1.3	Trajnimi i 61 koordinatorëve të të drejtës për informim në pushtetin vendor	KDIMDH								
		Nënaktiviteti 11.1.4	Të gjitha bashkitë miratojnë dhe zbatojnë programet e transparencës	KDIMDH		1,494					1,494	-
Aktiviteti 11.2	Përdorimi i mjeteve TIK për të rritur transparencën e veprimtarisë së administratës	Nënaktiviteti 11.2.1	Vënia në funksion të plotë i regjistrat qendror të kërkesave dhe përgjigjeve	KDIMDH	kosto administrative							
		Nënaktiviteti 11.2.2	Trajnimi i koordinatorëve për të drejtën e informimit lidhur me përdorimin e regjistrat qendror të kërkesave dhe përgjigjeve.	KDIMDH	kosto administrative							-
Aktiviteti 11.3	Rishikimi i zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit me synim përmirësimin e sjelljeve dhe metodës së zbatimit të programeve të transparencës; b) mekanizmat e përgjegjësisë administrative; dhe c) rritjes së publikimit proaktiv të informacionit publik.	Nënaktiviteti 11.3.1	Vlerësimi të plotë ex-post të Ligjit për të drejtën e informimit	KDIMDH		2,340						2,340
Aktiviteti 11.4	Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerezore të KDIMP për monitorimin e ligjit për të drejtën e informimit	Nënaktiviteti 11.4.1	Rishikimi i strukturës së KDIMP me synim forcimin e kapaciteteve monitoruese për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit	KDIMDH	kosto administrative	-						-
		Nënaktiviteti 11.4.2	Trajnime për forcim kapacitetesh në fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale	KDIMDH		2,545		2,545				
Totali koston Objekti 11						10,119	-	2,545	-	-	1,494	6,076
Totali i koston						1,720,154	905,933	290,021	37,028	87,364	332,594	67,213